

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Lutfi Zharku u takua me përfaqësues të Deutsche Bank



Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Lutfi Zharku, sot u takua me James Kotsomitis, Drejtor për Tregtinë Globale për Evropën Jugore dhe Francesco Caputo Nassetti, Drejtor menagjues.

Temë e këtij takimi ishte interesimi për investimet e Deutsche Bank në projektet publike në Kosovë. Ndërsa ministri Zharku i falënderoi për interesimin e tyre për të investuar në Kosovë, si dhe i njoftoi për mundësitë dhe kushtet që ofron Kosova për investitorë të huaj.